



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 57 prot.

Kamëz, më 17.7.2025

V E N D I M
Nr. 49. Datë 17/7 2025
MBI

“DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR DJEGIE BANESE”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.07.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.45 Datë 16.07.2025 në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligji, Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, neni 30, pika gj; VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 471, datë 03.07.2025, për evidentimin, konstatimin dhe vlerësimin e dëmeve në banesë, relacionit të hartuar nga ekspertët e administratës së Bashkisë në zbatim të urdhërit, dhe V.K.B. Kamëz Nr. 119, datë 19.12.2024 “Për miratimin e detajuar të buxhetit për vitin 2025 dhe planit të buxhetit për vitet 2025 , 2026, dhe 2027, struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare për djegie banese të:
 - z. , për banesën e dëmtuar nga zjarri datës 21.06.2025.
2. Të akordohet një ndihmë financiare për këtë familje si më poshtë:
 - në vlerën prej 93,097 (nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.
3. Kjo shumë të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz struktura buxhetore: Gr.0, Kap.05, Progr. 03280, Art. 606.
4. Ngarkohen Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOÇDASHI

